



---

**UNIVERSITETI I TETOVËS**  
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

# **R A P O R T**

## **PËR VETEVALUIMIN E FAKULTETIT TË ARTEVE**

**Tetovë, 2021**

**Fakulteti i Arteve-Факултет за уметности-Faculty of Arts**  
Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia  
[www.unite.edu.mk](http://www.unite.edu.mk) – e-mail: [arts@unite.edu.mk](mailto:arts@unite.edu.mk)

# PËRMBAJTJA

1.QËLLIMI I PROCESIT TË EVALUIMIT.....	3
2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT.....	3
2.1. Historiku.....	3
2.2. Misioni.....	4
2.3.Strategjitë e zhvillimit.....	5
3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT.....	6
3.1. Organogrami.....	6
3.2. Programet studimore.....	7
4.VEPRIMTARIA MËSIMORE.....	10
5. STRUKTURA E KUADRIT MËSIMOR-SHKENCOR.....	12
5.1. Programi studimor Arti Figurativ.....	13
5.2. Programi studimor Arti Muzikor.....	14
5.3. Programi studimor Arti Dramatik.....	15
5.4. Administrata e Fakultetit të Arteve.....	17
6. STRUKTURA E STUDENTËVE.....	16
6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike.....	16
6.2. Struktura e studentëve në studimet master.....	17
7. ANKETIMI I STUDENTËVE.....	19
8.VEPRIMTARIA SHKENCORE E ARTISTIKE SI DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE.....	21
9. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE.....	23
10. SWOT ANALIZA.....	25
11. KONKLUDIM.....	26

# 1. QËLLIMI I PROCESIT TË EVALUIMIT

Evaluimi, që u organizua në kuadër të Fakultetit të Arteve, kishte për qëllim të bëjë vlerësimin e procesit të mësimnxënies dhe mësimdhënies dhe do të shërbejë për rritje të kualitetit të procesit mësimor. Gjatë këtij procesi të evaluimit, ku ishin të përfshirë kuadri arsimor si dhe studentët, njëherësh u vlerësuan puna dhe kushtet në të cilat është zhvilluar procesi edukativ-mësimor. Mes tjerash, u bë edhe vlerësimi i programeve mësimore, me theks të veçantë për të rishikuar edhe një herë përputhshmërinë e tyre me Sistemin e Bolonjës. Konkretisht, në proces të evaluimit u përfshinë:

- Vlerësimi i programeve studimore, ku përfshihet themelimi, përshkrimi dhe zhvillimi i programeve studimore
- Struktura e kuadrit mësimor-shkencor
- Përshkrimi i realizimit të mësimdhënies
- Vlerësimi i veprimtarisë shkencore të kuadrit mësimor
- Studentët-struktura e studentëve dhe anketimi i studentëve që vlerësojnë më tepër komponentë
- Struktura e kuadrit administrativ dhe teknik; hapësirat dhe mjetet e realizimit të procesit mësimor.

Procesi i evaluimit në kuadër të Fakultetit të Arteve pati një rrjedhë tejet normale, i cili u zhvillua në një atmosferë pune, kurse bashkëpunimi dhe mirëkuptimi ishin në nivelin e duhur. Gjatë këtij procesi ishin inkuadruar të gjitha subjektet dhe strukturat që veprojnë në kuadër të fakultetit, dekanati, administrata, të cilët i vendosën në shfrytëzim të gjitha materialet dhe informacionet me të cilat disponon administrata e tij, materialet e përdorura, subjektet e inkuadruara, si dhe bashkëpunimi gjatë realizimit të procesit të evaluimit.

## 2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT

### 2.1. Historiku

Universiteti i Tetovës është themeluar më 17 dhjetor 1994, si iniciativë qytetare ndërsa prej shkurtit të vitit 2004 nga ana e Qeverisë së RMV me ligj të veçantë, Universiteti i

Tetovës fitoi statusin e institucionit të arsimit të lartë në RM me seli në Tetovë. Në kuadër të Universitetit të Tetovës më 1994 është themeluar edhe:

- Fakulteti i **Arteve Figurative** me katër drejtime artistike: **Pikturë, Skulpturë, Grafikë, Dizajn Grafik;**
- Fakulteti i **Artit Muzikor** me drejtimet: **Teoria e muzikës dhe e pedagogjisë, Solo këndimi, Piano, Instrumentet me hark;** dhe
- Fakulteti i **Artit Dramatik** me drejtimin **Aktrim** (i themeluar në vitin 1995).

Me zyrtarizmin e Universitetit Shtetëror të Tetovës, në vitin 2004 u themelua Fakulteti i Shkencave Humane dhe Arteve. Në kuadër të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Arteve, funksiononin programet studimore: Arti Figurativ dhe Arti Muzikor.

Në vitin 2007 me akreditimin e programeve të reja dhe duke u bazuar në Kartën e Bolonjës u themelua Fakulteti i Arteve si njësi akademike në kuadër USHT-së. (*Tabela 1*).

	Programi studimor	Vitet i themelimit
1	Arti figurativ	1994
2	Arti muzikor	1994
3	Arti dramatik	1995

*Tabela 1. Programet studimore në kuadër të Fakultetit të Arteve*

## 2.2. Misioni

Misioni i Fakultetit të Arteve është që fillimisht të krijojë kuadër të ardhshëm arsimor të mirëfilltë të arteve dhe artistë të ardhshëm, të cilët do të lënë gjurmë afatgjate në krijimtarinë artistike. Roli dhe detyra e Fakultetit të Arteve është realizimi dhe organizimi i studimeve sipas programeve studimore, të ciklit të parë dhe të dytë, respektivisht:

- Realizimi i kërkimeve fundamentale, zhvillimore e të aplikuara dhe realizimi i veprimtarive aplikative, transmetimi i njohurive e aftësive shkencore, profesionale e artistike etj.;
- Ofrimi i programeve dhe mjedisit studimor cilësor;
- Kultivimi i vlerave të një shoqërie demokratike, të barabartë, gjithëpërfshirëse dhe diversive;
- Sigurimi i një mjedisi të kultivuar, miqësor dhe bashkëpunues brenda institucionit;

- Avancimi i dijes, mendimit kritik dhe kreativitetit;
- Zhvillimi i kuptimit të plotë, të saktë dhe kritik ndaj artit, kontekstit të tij dhe marrëdhënieve ndërmjet artit dhe shoqërisë;
- Zgjerimi i praktikës artistike në sferën publike, duke përdorur më shumë lloje dhe forma të ekspozimit, skenës muzikore, teatrit, filmit etj.;
- Komunikimi në mënyrë vizuale, për të ndërtuar marrëdhënie dhe për t'u angazhuar audiencia etj.


### **2.3. Strategjitë e zhvillimit**

Fakulteti i Arteve është i përkushtuar që në kontinuitet të ofrojë mësimdhënie gjithnjë e më cilësore. Në përputhje me zhvillimet aktuale dhe të ardhshme, Fakulteti i Arteve në secilin program studimor dhe drejtim ku organizon studime do të ofrojë:

- Mësimdhënie interaktive, bazuar në teoritë dhe praktikatat më të mira bashkëkohore në qendër të të cilave do të jetë studenti/ja;
- Mësimdhënie, që integron pjesën relevante praktike në përputhje me specifikat e programeve përkatëse të studimit;
- Mësimdhënie e mbështetur në punë dhe projekte hulumtuese sipas specifikave;
- Mësimdhënie e bazuar në një raport të arsyeshëm për kontekstin profeso-student, duke shkuar drejt zbatimit të standardeve evropiane;
- Do ta forcojë bashkëpunimin me institucionet tjera simotra në vend dhe jashtë vendit;
- Do ta përmirësojë procesin e vlerësimit të brendshëm të mësimdhënies dhe programeve etj.

### 3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT

#### 3.1. Organogrami



Organet e Fakultetit janë Këshilli Mësimor-Shkencor, dekani dhe dekanati.

#### ***Këshilli Mësimor-Shkencor***

Këshilli Mësimor-Shkencor është organ menaxhues dhe organ profesional i Fakultetit, në përbërje të të cilit janë profesorë ordinarë, inordinarë dhe docentë, të cilët janë në marrëdhënie të rregullt pune në Fakultet.

Përfaqësuesit e studentëve përbëjnë 10% (dhjetë përqind) të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Mësimor-Shkencor dhe zgjidhen për një mandat prej dy vjetësh pa të drejtë rizgjedhjeje. Numri i studentëve në Këshillin Mësimor-Shkencor është i ndryshueshëm në varësi të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Mësimor-Shkencor.

## 3.2. Programet studimore

Programet studimore në kuadër të Fakultetit të Arteve kanë për qëllim realizimin dhe organizimin e studimeve sipas programeve të parapara për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve që në radhë të parë të krijojë kuadër të ardhshëm arsimor të arteve dhe artistë të artit figurativ, muzikor dhe dramatik.

Për të vlerësuar cilësinë e kryerjes së veprimtarisë së arsimit të lartë, menaxhimin, aktivitetet akademike dhe aktivitetet tjera si dhe përparësitë e tyre, Fakulteti kryen vetevaluim në interval kohe prej më së shumti 3 vjet.

Metodat e ligjërimit, ushtrimeve dhe aktiviteteve tjera të programeve studimore që përdoren janë sipas standardeve të fushave përkatëse dhe ofrojnë mundësi maksimale për përvetësimin e programeve studimore. Studenti është në qendër të vëmendjes me interaktivitet dhe përfshirje të plotë në të gjitha aktivitetet, me të cilat vijnë në shprehje afinitetet e tij.

Vlerësimi kryhet vazhdimisht gjatë gjithë semestrit, duke krijuar komunikim të mirë gjatë ndjekjes së aktiviteteve dhe përparimit me qëllim që të karakterizohet me objektivitet, relevancë dhe transparencë. Secili mësimdhënës është i detyruar t'i njoftojë studentët me standardet, procedurat dhe kriteret e vlerësimit duke marrë parasysh elementet e ndryshme siç janë aktivitetet e studentëve, prezantimet, detyrat, puna e pavarur etj.

Literatura e detyrueshme dhe plotësuese e shënuar në programin e lëndëve, është literaturë të cilën studentët e programeve studimore aktuale e kanë në dispozicion. Zgjerimi dhe sigurimi i literaturës së detyrueshme dhe plotësuese për çdo lëndë në veçanti, është e drejtë autonome e çdo mësimdhënësi – bartësit të lëndës. Mësimdhënësi i lëndës është bartës i literaturës adekuate dhe studentëve ua jep në fillim të çdo semestri. Mësimdhënësi literaturën e shënon në programin e lëndës (syllabus). Studentët kanë qasje të lirë në botimet elektronike të librave dhe revistave me çka u mundësohet njohje me literaturën relevante në nivel evropian dhe botëror. Programet studimore të ciklit të parë dhe të dytë përmbajnë lëndë obligative dhe zgjedhore. Lëndët obligative janë nga fushat përkatëse të programeve studimore. Lëndët mësimore zgjedhore studentët i zgjedhin nga lista e lëndëve mësimore zgjedhore të programeve studimore që kanë numër të barabartë të ECTS kredive. Në listën e lëndëve mësimore zgjedhore përfshihen gjithashtu lëndë mësimore që mësohen në njësi tjera të Universitetit. Përpos lëndëve të detyrueshme dhe zgjedhore, në programet studimore janë të parapara edhe lëndë opcionale (lëndët e lira zgjedhore), nga të cilat studentët mund të fitojnë njohuri dhe kredi. Në programin studimor të ciklit të parë të studimeve në artin

figurativ parashihet edhe punimi përfundimtar (punimi i diplomës). Programet studimore të ciklit të parë të studimeve sigurojnë kompetenca dhe aftësi profesionale të studentëve që kanë përfunduar studimet e tyre dhe mundësi për qasje më të mirë ndaj profesionit në përputhje me kornizën kombëtare të kualifikimeve profesionale, si dhe sigurojnë arsimim të përhershëm dhe qasje në njohuritë moderne profesionale dhe shkencore/artistike të kuadrove dhe profesionistëve në fushën e arteve. Me këtë mundësohet qasje në profesion të niveleve të ndryshme dhe në fusha të ndryshme që ofrojnë përgjigje gjithëpërfshirëse të nevojave të tregut të punës në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Sipas standardeve për kuadrin mësimor, studentët e drejtimeve pedagogjike mund të punësohen para sëgjithash si profesorë të artit në arsimin e mesëm-gjimnaz, arsimin e mesëm profesional, arsimin e mesëm artistik, arsimin fillor. Programe të ngjashme studimore të ciklit të parë të studimeve janë të përfshira në një numër të madh të universiteteve në rajon dhe botë dhe në masë të madhe korrespondojnë me hapësirën evropiane të arsimit të lartë, ndërsa lëndët që mësohen janë të përfshira në universitetet më të mira në Evropë. Programet studimore në masë të madhe janë të harmonizuara me shumë programe studimore nga hapësira e vetme evropiane e arsimit të lartë dhe japin mundësi për lëvizjen e stafit akademik dhe studentëve.

Cikli i parë i studimeve me kohëzgjatje 4-vjeçare (tetë semestra), 240 ECTS.

Niveli në kornizën nacionale të kualifikimit të arsimit të lartë		Arsimi i lartë	Niveli në kornizën evropiane të kualifikimeve të arsimit të lartë
VI	VIA	Cikli i I-rë i studimeve (studime universitare) 240 kredi	6

Për realizimin e veprimtarisë së tij, Fakulteti i Arteve është i organizuar në njësi të brendshme organizative në përputhje me Statutin e Universitetit, edhe atë:



## I-Programi studimor Arti Figurativ

	Drejtimi	Kualifikimi
1	Pedagogjik	Mësimdhënës i diplomuar i artit figurativ-piktor, skulptor apo grafist
2	Pikturë	Piktor i diplomuar
3	Grafikë	Grafist i diplomuar
4	Skulpturë	Skulptor i diplomuar
5	Dizajn Grafik	Dizajner grafik i diplomuar

*Tabela. 2a Drejtimet dhe kualifikimi*

## II-Programi studimor Arti Muzikor

	Drejtimi Teorik-pedagogjik	Kualifikimi
	Teorik-pedagogjik	Pedagog i diplomuar i muzikës
	Dirigjim	Dirigjent i diplomuar
	Kompozim	Kompozitor i diplomuar
	Muzikologji	Muzikolog i diplomuar
	Etnomuzikologji	Etnomuzikolog i diplomuar
	<b>Drejtimi Vokal-instrumental:</b>	
1	Solo këndim	Solo këngëtar i diplomuar
2	Piano	Pianist i diplomuar
3	Violinë	Violinist i diplomuar
4	Violë	Violist i diplomuar
5	Violonçel	Violonçelist i diplomuar
6	Kontrabas	Kontrabassist i diplomuar
7	Kitarë	Kitarist i diplomuar
8	Flautë	Flautist i diplomuar
9	Klarinetë	Klarinetist i diplomuar
10	Oboa	Oboist i diplomuar
11	Fagot	Fagotist i diplomuar
12	Tubë	Tubist i diplomuar
13	Korno	Kornist i diplomuar
14	Trombon	Trombonist i diplomuar
15	Instrumente me goditje	Perkusionist i diplomuar
16	Fizarmonikë	Fizarmonicist i diplomuar

*Tabela. 2b Drejtimet dhe kualifikimi*

### III-Programi studimor Arti Dramatik

	Drejtimi	Kualifikimi
1	Aktrim	Aktor i diplomuar
2	Dramaturgji	Dramaturg i diplomuar
3	Regji teatri	Regjisor teatri i diplomuar
4	Regji filmi dhe TV	Regjisor filmi dhe TV i diplomuar
5	Kinematografi	Kinematograf i diplomuar
6	Montazhë	Montazher i diplomuar

*Tabela. 2c Drejtimet dhe kualifikimi*

**Cikli i dytë i studimeve** me kohëzgjatje 1-vjeçare (dy semestra), 60 ECTS

### Programi studimor Arti Figurativ

	Drejtimi/moduli	Kualifikimi
1	Pikturë	Magjistër i artit figurativ + emri i modulit
2	Skulpturë	
3	Grafikë	
4	Dizajn Grafik	

*Tabela 2ç. Drejtimet-modulet dhe kualifikimi*

## 4. VEPRIMTARIA MËSIMORE

Në të tre programet studimore të Fakultetit të Arteve organizohen studime të ciklit të parë që janë kompatible me sistemin evropian të kredive (ECTS) dhe që përgatiten kuadro profilesh të ndryshme nga fusha e arteve. Çdo program studimor në vete përmban disa drejtime, edhe atë drejtimin pedagogjik si dhe një numër të caktuar të drejtimeve artistike (*Tabela 2a, 2b, 2c*).

Në Fakultetin e Arteve në programin studimor Arti Figurativ realizohen studime edhe të ciklit të dytë, në disa drejtime-module të caktuara (*Tabela 2ç*).

Në Fakultetin e Arteve procesi mësimor realizohet me mësim teorik dhe praktik. Mësimdhënia realizohet sipas dinamikës së paraparë në programin e Fakultetit të Arteve. Për realizim të procesit mësimor gjegjësisht të pjesës praktike përdoren hapësirat e fakultetit me pajisjet përkatëse, kurse pjesa pedagogjike realizohet në shkollat fillore me të cilat është

nënshkruar marrëveshje paraprake bashkëpunimi. Gjithashtu, në të gjitha programet studimore, në afatet e parapara të semestrave përkatës realizohen kolokuiumet për çdo lëndë.

Studimet e ciklit I (të parë) zgjasin katër vite akademike (tetë semestra) dhe studentët fitojnë gjithsej 240 kredi. Studimet e ciklit të dytë zgjasin një vit akademik (dy semestra) me gjithsej 60 kredi

Me mbrojtjen e suksesshme të punimit të diplomës, studenti merr diplomë për studimet e kryera dhe thirrjet përkatëse, të dhëna më poshtë:

### ***Programi studimor -Arti figurativ***

Pas diplomimit në ciklin e I-rë (parë) të studimeve, studentët e drejtimit pedagogjik marrin diplomën me thirrjet si vijojnë:

- Mësimdhënës i diplomuar i artit figurativ-piktor, skulptor apo grafist (*varësisht nga moduli i zgjedhur*), ndërsa studentët e drejtimeve artistike marrin diplomën me thirrjen:
- Piktor i diplomuar,
- Skulptor i diplomuar ,
- Grafist i diplomuar,
- Dizajner grafik i diplomuar.

Pas mbarimit të ciklit II (dytë) studentët marrin titullin:

Magjistër i Artit Figurativ +(moduli) Pikturë, Skulpturë, Grafikë ose Dizajn grafik.

### ***Programi studimor -Arti Muzikor***

Pas diplomimit në fusha përkatëse profesionale dhe artistike studentët marrin diplomën me thirrjen:

- Pedagog i diplomuar i muzikës
- Dirigjent i diplomuar
- Kompozitor i diplomuar
- Muzikolog i diplomuar
- Etnomuzikolog i diplomuar
- Solo këngëtar i diplomuar
- Pianist apo klarinetist i diplomuar (*varësisht nga moduli i zgjedhur*).

## ***Programi studimor -Arti Dramatik***

Pas diplomimit në fusha përkatëse profesionale dhe artistike studentët marrin diplomën me thirrjen:

- Aktor i diplomuar
- Dramaturg i diplomuar
- Regjisor teatri i diplomuar
- Regjisor filmi dhe TV i diplomuar
- Kinematograf i diplomuar
- Montazher i diplomuar

Fakulteti i Arteve ka bashkëpunim të vazhdueshëm me universitetet tjera rajonale. Vlen të përmendet bashkëpunimi me universitetet shqiptare edhe atë me Universitetin e Arteve në Tiranë dhe Fakultetin e Arteve të Universitetit të Prishtinës, si në planin e përafrimit të planprogrameve mësimore, por edhe në organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në planin artistik siç është “Ura me Tri Harqe”, e cila realizohet çdo vit sipas rotacionit. Bashkëpunim të rregullt kemi me Akademinë e Arteve në kuadër të Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” të Shkupit dhe me disa universitete të Turqisë, Bullgarisë, etj. Procesi arsimor-shkencor e artistik në Fakultetin e Arteve realizohet në dy objekte në Tetovë.

## **5. STRUKTURA E KUADRIT MËSIMOR-SHKENCOR**

Në Fakultetin e Arteve, gjatë periudhës nga viti akademik 2016/17 deri më 2018/19 procesin arsimor e kanë realizuar gjithsej 32 mësimdhënës me marrëdhënie të rregullt pune. Procesi i zgjedhjes dhe rizgjedhjes së kuadrit mësimor, mësimor -shkencor i Fakultetit të Arteve është realizuar në pajtim me kriteret e parapara sipas Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Statutit të Universitetit të Tetovës. Për realizimin e procesit mësimor, përveç kuadrit të rregullt kanë qenë të angazhuar me kontratë edhe një numër i caktuar i mësimdhënësve. Ky numër ka qenë i ndryshueshëm përgjatë viteve për shkak të drejtimeve që kanë pauzuar si dhe numrit të studentëve që janë regjistruar. Raporti gjinor midis mësimdhënësve të punësuar të rregullt në Fakultetin e Arteve nuk është i balancuar pasi vetëm 22% nga numri i përgjithshëm i tyre i përket gjinisë femërore.

Në tabelat e radhës sipas programeve studimore janë pasqyruar numri i mësimdhënësve dhe i bashkëpunëtorëve të rregullt dhe të angazhuar me kontratë përgjatë viteve akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19.

### 5.1. Programi studimor Arti Figurativ

Në programin studimor Art Figurativ në kuadër të Fakultetit të Arteve me marrëdhënie të rregullt pune në periudhën gjatë viteve akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 kanë qenë gjithsej 18 mësimdhënës (ndërkohë 1 ka shkuar në pension dhe 1 është punësuar). Në vitin akademik 2018/19 nga numri i përgjithshëm i të punësuarve me marrëdhënie të rregullt pune ka qenë gjithsej 18, prej të cilëve 4 i takojnë gjinisë femërore ose 22% e mësimdhënësve ndërsa në vitet akademike 2016/17 dhe 2017/18 vetëm 3 mësimdhënës të gjinisë femërore ose 16% (*Tabela 3a*), po ashtu ka pasur 5 përkatësisht 3 bashkëpunëtorë të jashtëm të angazhuar. Duke marrë parasysh numrin e studentëve të regjistruar në programin studimor Art Figurativ gjatë viteve akademike të lartpërmendura (*Tabela 4a*), konstatojmë se një mësimdhënës bashkëvepron me gjashtë studentë, numër i pëlqyeshëm për realizim të mirëfilltë të procesit mësimor.

ARTI FIGURATIV									
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2016/17									
Të rregullt					Me kontratë				
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	6	0	6	50-62	Ordinar	0	0	0	0
Inordinar	6	0	6	46-57	Inordinar	0	0	0	0
Docent	3	2	5	27-37	Docent	0	0	0	0
Asistent	0	1	1	36	Mr	1	3	4	30-42
I diplomuar	0	0	0	0	I diplomuar	1	0	1	30
<b>Gjithsej</b>	<b>15</b>	<b>3</b>	<b>18</b>		<b>Gjithsej</b>	<b>2</b>	<b>3</b>	<b>5</b>	
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2017/18									
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	6	0	6	51-63	Ordinar	0	0	0	0
Inordinar	6	0	6	47-58	Inordinar	0	0	0	0

Docent	3	2	5	28-38	Docent	0	0	0	0
Asistent	0	1	1	37	Mr	2	1	3	31-43
I diplomuar	0	0	0	0	I diplomuar	0	0	0	0
<b>Gjithsej</b>	<b>15</b>	<b>3</b>	<b>18</b>		<b>Gjithsej</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2018/19									
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	9	0	9	50-63	Ordinar	0	0	0	0
Inordinar	5	2	7	39-56	Inordinar	0	0	0	0
Docent	0	2	2	29-39	Docent	0	0	0	0
Asistent	0	0	0	0	Mr	2	1	3	32-44
I diplomuar	0	0	0	0	I diplomuar	0	0	0	0
<b>Gjithsej</b>	<b>14</b>	<b>4</b>	<b>18</b>		<b>Gjithsej</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>3</b>	

*Tabela 3a. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë, programi studimor, Arti Figurativ*

## 5.2. Programi studimor Arti Muzikor

Në programin studimor Art Muzikornë kuadër të Fakultetit të Arteve në marrëdhënie të rregullt pune në periudhën nga viti akademik 2016/17 deri më 2018/19 kanë qenë gjithsej 10 mësimdhënës, prej të cilëve 3 i takojnë gjinisë femërore ose 30% e mësimdhënësve. Për realizimin e procesit mësimor poashtu kanë qenë të angazhuar edhe 13 bashkëpunëtorë të jashtëm (*Tabela 3b*). Duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar në programin studimor art muzikor gjatë viteve akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 (*Tabela 4a*), shohim se një mësimdhënës në marrëdhënie të rregullt pune apo bashkëpunëtor i jashtëm ka ndjekur punën individuale të tre deri katër studentëve.

<b>ARTI MUZIKOR</b>									
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2016/17									
Të rregullt					Me kontratë				
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	5	0	5	46-64	Ordinar	2	0	2	53-62
Inordinar	2	2	4	34-57	Inordinar	3	2	5	48-78
Docent	0	1	1	38	Dr	1	0	1	48

Asistent	0	0	0	0	Mr	3	2	5	24-38
I diplomuar	0	0	0	0	I diplomuar	0	0	0	0
<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>3</b>	<b>10</b>		<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>4</b>	<b>13</b>	
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2017/18									
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	5	0	5	47-65	Ordinar	2	0	2	54-63
Inordinar	2	2	4	35-58	Inordinar	3	2	5	49-79
Docent	0	1	1	39	Dr	1	0	1	49
Asistent	0	0	0	0	Mr	3	2	5	25-39
I diplomuar	0	0	0	0	I diplomuar	0	0	0	0
<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>3</b>	<b>10</b>		<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>4</b>	<b>13</b>	
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2018/19									
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	5	0	5	48-66	Ordinar	2	0	2	55-64
Inordinar	2	2	4	36-59	Inordinar	3	2	5	50-80
Docent	0	1	1	40	Dr	1	0	1	50
Asistent	0	0	0	0	Mr	3	2	5	26-40
I diplomuar	0	0	0	0	I diplomuar	0	0	0	0
<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>3</b>	<b>10</b>		<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>4</b>	<b>13</b>	

*Tabela 3b. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë, programi studimor, Arti Muzikor*

### 5.3. Programi studimor Arti Dramatik

Në programin studimor Art Dramatik në kuadër të Fakultetit të Arteve në marrëdhënie të rregullt pune në periudhën nga viti akademik 2016/17 deri më 2018/19 kanë qenë gjithsej 4 mësimdhënësit dhe të gjithë të gjinisë mashkullore. Për realizimin e procesit mësimor poashtu kanë qenë të angazhuar edhe 9 përkatësisht 11 bashkëpunëtorë të jashtëm (*Tabela 3c*). Duke pasur parasysh numrin e përgjithshëm të studentëve të regjistruar në programin studimor Art Dramatik gjatë viteve akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 (*Tabela 4a*), shohim se një mësimdhënësi në marrëdhënie të rregullt pune apo bashkëpunëtor i jashtëm ka ndjekur punën individuale të tre studentëve.

<b>ARTI DRAMATIK</b>									
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2016/17									
Të rregullt					Me kontratë				
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	0	0	0	0	Ordinar	2	1	3	50-64
Inordinar	2	0	2	46-50	Inordinar	2	0	2	47-52
Docent	2	0	2	40-46	Dr	1	1	2	40-47
Asistent	0	0	0	0	Mr	2	0	2	27-35
I diplomuar	0	0	0	0	I diplomuar	0	0	0	0
<b>Gjithsej</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>4</b>		<b>Gjithsej</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>9</b>	
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2017/18									
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	0	0	0	0	Ordinar	3	0	3	50-64
Inordinar	2	0	2	47-51	Inordinar	2	0	2	47-52
Docent	2	0	2	41-47	Dr	2	0	2	40-47
Asistent	0	0	0	0	Mr	2	0	2	27-35
I diplomuar	0	0	0	0	I diplomuar	0	0	0	0
<b>Gjithsej</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>4</b>		<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>0</b>	<b>9</b>	
Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt dhe të angazhuar me kontratë gjatë vitit akademik 2018/19									
Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha	Thirrjet	M	F	Gjithsej	Mosha
Ordinar	2	0	2	48-52	Ordinar	3	0	3	52-64
Inordinar	1	0	1	42	Inordinar	2	0	2	47-52
Docent	1	0	1	48	Dr	2	0	2	36-47
Asistent	0	0	0	0	Mr	2	0	2	27-35
I diplomuar	0	0	0	0	I diplomuar	2	0	2	26-40
<b>Gjithsej</b>	<b>4</b>	<b>0</b>	<b>4</b>		<b>Gjithsej</b>	<b>11</b>	<b>0</b>	<b>11</b>	

*Tabela 3c. Mësimdhënësit dhe bashkëpunëtorët e rregullt, dhe të angazhuar me kontratë, programi studimor, Arti Dramatik*



## 5.4. Administrata e Fakultetit të Arteve

Në Fakultetin e Arteve çështjet administrative menaxhohen nga gjithsej 22 administratorë, prej të cilëve 3 janë me studime master, 14 me arsim të lartë dhe 5 me arsim të mesëm. Raporti administrator/referent ndaj studentëve është afërsisht 1:6.5. Ndërsa për mbarëvajtjen e punëve teknike janë të angazhuar gjithsej 5 punëtorë teknik.

## 6. STRUKTURA E STUDENTËVE

### 6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike

	PROGRAMI STUDIMOR	Viti akademik	Të rregullt	Me korrespondencë	Gjithsej	Projekt 35/45	SH.H.	Nacionaliteti
1	Arti Figurativ	2016/2017	96	/	96	/	12	5
		2017/2018	104	/	104	/	11	4
		2018/2019	96	/	96	/	12	4
2	Arti Muzikor	2016/2017	30	/	30	/	9	3
		2017/2018	21	/	21	/	/	6
		2018/2019	25	/	25	/	7	1
3	Arti Dramatik	2016/2017	25	/	25	/	1	3
		2017/2018	6	/	6	/	/	/
		2018/2019	11	/	11	/	5	1

*Tabela 4a. Numri i studentëve të regjistruar në programin studimor Art Figurativ, cikli I, gjatë viteve akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19*

### 6.2. Struktura e studentëve në studimet master

	PROGRAMI STUDIMOR	Viti akademik	Të rregullt	Me korrespondencë	Gjithsej	Projekt 35/45	SH.H.	Nacionaliteti
1	Arti	2016/2017	0	/	0	/	/	/

Figurativ	2017/2018	2	/	2	/	/	/
	2018/2019	1	/	1	/	/	/

**Tabela 4b.** Numri i studentëve të regjistruar në programin studimor Art Figurativ, cikli II, gjatë viteve akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19

### **Promovimi i Fakultetit**

Promovimi i Fakultetit të Arteve bëhet në kuadër të promovimit të përgjithshëm të Universitetit të Tetovës. Gjatë muajit prill, përfaqësues të UT-së realizojnë prezantime para maurantëve të shkollave të mesme në qytete të ndryshme si në RMV, ashtu edhe në vendet fqinje. Në këto prezantime maurantët për së afërmi njoftohen me fakultetet, programet studimore, si dhe mundësitë tjera për studime që i ofron UT-ja. Pjesa tjetër e promovimit të Fakultetit të Arteve bëhet gjatë ditëve të hapura, ku maurantët kanë mundësi për së afërmi të përjetojnë hapësirat si dhe mundësitë tjera që i ofron Fakulteti i Arteve. Të drejtë për aplikim dhe regjistrim në ciklin e parë të studimeve universitare ka individi i cili ka dhënë maturë shtetërore, maturë ndërkombëtare ose maturë shkollore të arsimit artistik dhe që i plotëson kriteret e parapara në konkursin për regjistrim. Të gjithë kandidatët që kanë aplikuar i nënshtrohen kontrollit të njohurive dhe shkathtësive të parapara për Fakultetin e Arteve, gjegjësisht të programeve studimore përkatëse. Në Fakultetin e Arteve në vitin akademik 2016/17 numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar për katër vite të studimit gjithsej ka qenë 151 studentë. Prej tyre 15% kanë qenë nga shtete tjera dhe 7% u takojnë nacionaliteteve që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në vitin akademik 2017/18 numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar për katër vite të studimit gjithsej ka qenë 131 studentë. Prej tyre 8% kanë qenë nga shtete tjera dhe 7.5% u takojnë nacionaliteteve që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Në vitin akademik 2018/19 numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar për katër vite të studimit gjithsej ka qenë 132 studentë. Prej tyre 18% kanë qenë nga shtete tjera dhe 4.5% u takojnë nacionaliteteve që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

FAKULTETI I ARTEVE					
Viti akademik	Gjithsej numri i studentëve të regjistruar	Shtete tjera		Nacionalitete tjera	
		Nr	%	Nr	%

2016/2017	151	22	<b>15</b>	11	<b>7</b>
2017/2018	131	11	<b>8</b>	10	<b>7.5</b>
2018/2019	132	24	<b>18</b>	6	<b>4.5</b>

**Tabela 5.** Studentët e regjistruar në Fakultetin e Arteve, cikli I, gjatë viteve akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 e shprehur sipas numrit dhe përqindjes së shtetasve dhe nacionaliteteve tjera

## 7. ANKETIMI I STUDENTËVE

### *Realizimi i orës mësimore në programet studimore të Fakultetit të Arteve*

Për vlerësim të realizimit të orës mësimore janë plotësuar 177 pyetësorë. Rreth 89% e përgjigjeve nga studentët në Fakultetin e Arteve vlerësojnë se ligjëratat fillojnë saktë sipas orarit, kurse rreth 90% se ligjëratat mbarojnë në kohën e paraparë sipas orarit të shpallur. Përqindja më e madhe e studentëve që deklarojnë se ligjëratat fillojnë dhe mbarojnë sipas orarit të paraparë janë në programin studimor Art Dramatik (90%) dhe Art Muzikor (94%). Rreth 37% e studentëve në Fakultetin e Arteve deklarojnë se gjatë ligjëratës kanë bërë pauzë 10 deri 15 minuta. Sipas programeve studimore në Art Dramatik numri më i madh i studentëve (rreth 90%) deklarojnë se gjatë ligjëratave nuk bëjnë pauzë.

Për realizim të orëve gjatë ligjëratave në Fakultetin Arteve përdoren mjete të ndryshme për prezantim. Studentët deklarojnë (rreth 13%) se gjatë ligjëratës mësimdhënësit kanë përdorur vizatime, sipas programeve studimore në Art Dramatik diku rreth 20% kanë përdorur fleta, Art Muzikor diku 16 % kanë përdorur tabelë.

	Tema përputhshmëria me ligjëratat	Ligjërata të qarta	Ligjërues i sigurt	Ligjërues bindës
	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)
<b>Art Figurativ</b>	4.22 (87)	4.77 (87)	4.85 (87)	4.76 (87)
<b>Art Muzikor</b>	4.63 (80)	4.64 (80)	4.82 (80)	4.79 (80)
<b>Art Dramatik</b>	5.00 (10)	4.80 (10)	4.90 (10)	4.90 (10)

**Tabela 6a.** Mesataret e indikatorëve të realizimit të ligjëratave

## ***Realizimi i ligjëratave***

Studentët kanë vlerësuar realizimin e orës në lëndë të caktuara nëpërmjet shtatë pyetjeve. Në kuadër të Fakultetit të Arteve, studentët kanë vlerësuar pozitivisht realizimin e orës më të gjitha pyetjet. Edhe atë vlerësim më pozitiv kanë dhënë për sigurinë, bindshmërinë dhe qartësinë e mësimdhënësve gjatë ligjërimit (M= 4.84; M=4.78; M=4.71). Që të tre karakteristikat e mësimdhënësve janë vlerësuar si dominonte pozitive në të gjitha programet studimore të Fakultetit të Arteve.

*Përmbajtja e ligjërimit/prezantimit* është vlerësuar nëpërmjet 14 pohimeve, në të cilat janë përgjigjur me pesë opsione të mundshme, prej aspak nuk pajtohem(1) deri plotësisht pajtohem (5). Studentët kanë deklaruar se materiali i prezantuar gjatë ligjërimit ka qenë në përputhshmëri me temën e prezantuar në fillim të orës (M=4.75), mësimdhënësit kanë pyetur çka nuk kanë të qartë studentët (M=4.46) dhe se studentët e kanë pasur të qartë në çka duhet të fokusohen për të përgatitur temën në lëndën konkrete (M=4.51). Sipas programeve studimore, studentët e Artit Muzikor kanë vlerësuar se mund të jetë prezente më shumë lidhshmëria e koncepteve me lëndët tjera gjatë ligjëratave (M=2.94).

	Orientim në pikat kyçe të temës	Lidhshmëri me tema tjera	Ilustrim me shembuj i përmbajtjes	Lidhshmëri për përdorim të njohurive në praktikë	Motivon për pjesëmarrje aktive në ligjërata
	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)
<b><i>Art Figurativ</i></b>	4.54 (87)	4.07 (87)	4.50 (87)	4.16 (87)	4.49 (87)
<b><i>Art Muzikor</i></b>	4.54 (80)	4.06 (80)	4.03 (80)	3.90 (80)	4.21 (80)
<b><i>Art Dramatik</i></b>	4.80 (10)	4.10 (10)	4.90 (10)	4.90 (10)	4.70 (10)

***Tabela 6b. Mesataret e indikatorëve të përmbajtjes së ligjëratave***

*Menaxhimi i orës* është vlerësuar nëpërmjet shtatë pohimeve. Përgjigjet e mundshme në të gjitha pohimet kanë lëvizur prej opsionit aspak nuk pajtohem (1) deri plotësisht pajtohem (5). Studentët në nivel të fakultetit japin vlerësime pozitive në pyetjet duke veçuar se nuk ka pasur zhurmë gjatë ligjërates (M=0.91), në lidhje me menaxhimin e orës gjatë

ligjëratës (M=3.87), kanë qenë të koncentruar në ligjëratë (M=3.79) dhe se mësimdhënësi në mënyrë aktive ka qenë i orientuar nga studentët (M=4.47) .

*Interaksionin joverbal* të mësimdhënësve studentët e kanë vlerësuar nëpërmjet dhjetë pohimeve, gjithashtu me pesë opsione të mundshme për përgjigje edhe atë prej aspak nuk pajtohem (1) deri plotësisht pajtohem (5). Në tërësi studentët vlerësojnë pozitivisht interaksionin e mësimdhënësve ndaj tyre gjatë realizimit të ligjëratës. Kontakti joverbal me të gjithë studentët si vëzhgim i balancuar ndaj gjithë studentëve (M=4.52). Megjithatë, në përgjithësi studentët e Fakultetit të Arteve vlerësojnë se janë të kënaqur me mënyrën e organizimit të ligjëratave (M=4.60).

	Dëgjoi në mënyrë aktive komentet e studentëve	Stimuloi për pjesëmarrje aktive në ligjëratë	Ishte i paanshëm gjatë diskutimit të studentëve	Mbajti koncentrimin e studentëve	Vëzhgim i balancuar ndaj të gjithë studentëve	Të kënaqur nga realizimi i orës
	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja (N)	Mesatarja(N)
<i>Art Figurativ</i>	3.94 (87)	3.71 (87)	4.04 (87)	4.51 (87)	4.40 (87)	4.68 (87)
<i>Art Muzikor</i>	3.49 (80)	3.44 (80)	3.54 (80)	4.36 (80)	4.63 (80)	4.52 (80)
<i>Art Dramatik</i>	4.90 (10)	4.90 (10)	4.90 (10)	4.90 (10)	4.70 (10)	4.60 (10)

*Tabela 6c. Mesataret e indikatorëve të përmbajtjes së menaxhimit të orës nga mësimdhënësi*

## 8. VEPRIMTARIA SHKENCORE E ARTISTIKE SI DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE

Gjatë viteve akademike 2016/17, 2017/18, 2018/19 Fakulteti i Arteve ka organizuar disa aktivitete shkencore/artistike si konferenca, ekspozita, koncerte, shfaqje teatrale, filma etj. ndërkombëtare, rajonale dhe vendore. Gjatë çdo përfundimi të vitit akademik studentët e të gjitha programeve studimore, veçmas, organizojnë prezantime finale publike. Studentët e

Artit Figurativ organizojnë ekspozitë të studentëve për publikun. Pastaj, studentët e Artit Muzikor paraqiten me koncert, kurse ata të Artit Dramatik me shfaqje teatrale para publikut të Tetovës. Vlen të përmendet organizimi i aktiviteteve të përbashkëta siç është projekti “Ura me Tri Harqe”, i cili realizohet çdo fund viti sipas rotacionit me studentët e Universitetit të Arteve në Tiranë dhe Fakultetit të Arteve të Universitetit të Prishtinës.

Mësimdhënësit e Fakultetit të Arteve krahas realizimit të procesit mësimor dhe aktiviteteve tjera lidhur me të kanë qenë edhe pjesëmarrës dhe bartës të projekteve të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare. Në vazhdim është prezantuar një pjesë e aktiviteteve individuale, grupore dhe kolektive e mësimdhënësve të rregullt të Fakultetit të Arteve sipas programeve studimore.

### ***Programi studimor Arti Figurativ***

<b>Aktivitetet shkencore dhe artistike të mësimdhënësve të rregullt</b>					
Viti akademik	Konferenca ndërkombëtare	Publikime	Ekspozita		Simpoziume dhe koloni artistike
			personale	kolektive	
2016/2017	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>13</b>	<b>26</b>	<b>13</b>
2017/2018	<b>0</b>	<b>7</b>	<b>9</b>	<b>32</b>	<b>7</b>
2018/2019	<b>1</b>	<b>7</b>	<b>11</b>	<b>61</b>	<b>12</b>

***Tabela 7a.*** Aktivitetet shkencore dhe artistike të mësimdhënësve të rregullt, programi studimor Arti Figurativ

### ***Programi studimor Arti Muzikor***

<b>Aktivitetet shkencore dhe artistike të mësimdhënësve të rregullt</b>					
Viti akademik	Konferenca ndërkombëtare	Publikime	Pjesëmarrja në projekte		Publikime artistike interpretim të veprave muzikore
			rajonale	vendore	
2016/2017	<b>5</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>6</b>
2017/2018	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>4</b>
2018/2019	<b>12</b>	<b>5</b>	<b>6</b>	<b>11</b>	<b>3</b>

***Tabela 7b.*** Aktivitetet shkencore dhe artistike të mësimdhënësve të rregullt, programi studimor Arti Muzikor

## *Programi studimor Arti Dramatik*

<b>Aktivitetet shkencore dhe artistike të mësimdhënësve të rregullt</b>				
Viti akademik	Konferenca ndërkombëtare	Publikime	Pjesëmarrja në projekte	
			rajonale	vendore
2016/2017	<b>0</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>5</b>
2017/2018	<b>0</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>5</b>
2018/2019	<b>0</b>	<b>5</b>	<b>4</b>	<b>5</b>

*Tabela 7c. Aktivitetet shkencore dhe artistike të mësimdhënësve të rregullt, programi studimor Arti Dramatik*

## **9. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE**

Fakulteti i Arteve procesin mësimor-shkencor/artistik e realizon në dy objekte në Tetovë. Programi studimor Arti Figurativ gjendet te objekti qendror (objekti ish-Rektorati) ndërsa programi studimor Arti Muzikor dhe Arti Dramatik gjenden në kuadër të objektit të Qendrës për Kulturë në Tetovë. Poashtu për realizimin sa më efikas të ligjëratave dhe mësimin praktik shfrytëzohen hapësira edhe të objekteve tjera. Hapësirat dhe pajisjet që përdoren janë të paraqitura në tabelat e më poshtme (*Tabela 8a, 8b, 8c, 8ç, 8d, 8e*) të specifikuar sipas programeve studimore dhe atë:

### *Programi studimor Arti Figurativ*

	<b>Hapësira</b>	<b>Njësitë</b>	<b>Ulëse</b>	<b>Hapësira m2</b>
1	Kabineti për pikturë	2	12	120
2	Kabineti për skulpturë	1	3	80
3	Kabineti për grafikë	2	16	120
4	Kabineti për dizajn grafik	1	20	80
5	Kabineti për akt	1	10	80
6	Kabineti për teknologji	1	5	80
7	Hapësira administrative	5	30	200
8	Klasa për leksione	2	60	90
	<b>Gjithsej</b>	<b>15</b>	<b>156</b>	<b>850</b>

**Tabela 8a.** Hapësirat e UT-së, në dispozicion të programit studimor Arti Figurativ të Fakultetit të Arteve

	Pajisjet/lloji i pajisjeve	Numri	Qëllimi
1	Kompjuter	15	Për kuadrin arsimor, administratën dhe studentët
2	Konektor internet	5	Për studentët
3	LCD projektor	1	Për kuadrin arsimor dhe administratën
4	Skanerë	1	Për kuadrin arsimor dhe administratën
5	Printer	5	Për kuadrin arsimor dhe administratën
6	Fotokopjues	1	Për kuadrin arsimor dhe studentët
7	Kavaletë	40	Për studentët
8	Presë grafike	1	Për studentët
9	Dhomë për përpunimin kimik të pllakave grafike	1	Për studentët
10	Mjete adekuate për punë në skulpturë		Për studentët
11	Prerës qelqi për vitrazhë	1	Për studentët

**Tabela 8b.** Pajisjet në dispozicion të programit studimor Arti Figurativ të Fakultetit të Arteve

### **Programi studimor Arti Muzikor**

	Hapësira	Njësitë	Ulëse	Hapësira m2
1	Kabinet për piano	1	3	15
2	Sallë koncertale	1	100	300
3	Zyra e profesorëve	1	6	15
4	Hapësira administrative	2	15	70
5	Klasa për leksione	4	120	160
	<b>Gjithsej</b>	<b>9</b>	<b>244</b>	<b>560</b>

**Tabela 8c.** Hapësirat e UT-së, në dispozicion të programit studimor Arti Muzikor të Fakultetit të Arteve

	Pajisjet/lloji i pajisjeve	Numri	Qëllimi
1	Kompjuter	3	Për kuadrin arsimor, administratën dhe studentët
2	Konektor interneti	1	Për studentët
3	Skanerë	1	Për kuadrin arsimor dhe administratën
4	Printer	1	Për kuadrin arsimor dhe administratën



5	Fotokopjues	1	Për kuadrin arsimor dhe studentët
6	Piano muri(pianino)	7	Për kuadrin arsimor dhe studentët
7	Piano gjysmëkoncertale	1	Për kuadrin arsimor dhe studentët
8	Skanerë	1	Për kuadrin arsimor dhe administratën

**Tabela 8ç.** Pajisjet në dispozicion të programit studimor *Arti Muzikor* të Fakultetit të Arteve

### **Programi studimor *Arti Dramatik***

	<b>Hapësira</b>	<b>Njësitë</b>	<b>Ulëse</b>	<b>Hapësira m2</b>
1	Salla e Artit Dramatik	1	100	300
2	Kabineti për Regji Filmi	1	10	40
3	Kabineti për Montazhë	1	10	40
4	Kabineti për Kamerë	1	10	40
5	Kabineti për Fotografi	1	8	30
6	Salla për ushtrime	1	/	80
7	Hapësira administrative	2	30	90
8	Klasa për leksione	2	60	120
	<b>Gjithsej</b>	<b>10</b>	<b>228</b>	<b>740</b>

**Tabela 8d.** Hapësirat e UT-së, në dispozicion të programit studimor *Arti Dramatik* të Fakultetit të Arteve

	<b>Pajisjet/lloji i pajisjeve</b>	<b>Numri</b>	<b>Qëllimi</b>
1	Konektor internet	1	Për studentët
2	Skanerë	1	Për kuadrin arsimor dhe administratën
3	Printerë	2	Për kuadrin arsimor dhe administratën

**Tabela 8e.** Pajisjet në dispozicion të programit studimor *Arti Dramatik* të Fakultetit të Arteve

## **10. SWOT ANALIZA**

**Tabela 9.** SWOT analiza në kuadër të Fakultetit të Arteve

<b>ANËT E FORTA</b>	<b>ANËT E DOBËTA</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Staf i kualifikuar dhe ambicioz;</li> <li>• Aplikimi i modeleve të reja të mësimdhënies;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesa e shkollave të mesme artistike në vend;</li> <li>• Konkurrenca jo e mjaftueshme në përzgjedhjen e</li> </ul>

<ul style="list-style-type: none"> <li>• Përgjegjshmëri në realizimin e procesit mësimor;</li> <li>• Raporte të mira midis stafit akademik dhe studentëve;</li> <li>• Lidhje të ngushta me tregun e punës;</li> <li>• Aktivitet i konsoliduar shkencor/artistik i stafit akademik;</li> <li>• Ofrim i programeve studimore në përputhje me nevojat e tregut.</li> </ul>	<p>kandidatëve në drejtime të caktuara;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Mosorientimi me kohë i nxënësve për profesionin që e zgjedhin;</li> <li>• Promocion i pamjaftueshëm i programeve studimore në rekrutimin e studentëve të rinj.</li> </ul>
<b>MUNDËSITË</b>	<b>KËRCËNIMET</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Marrëdhënie të qëndrueshme bashkëpunimi me universitetet me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi;</li> <li>• Projekte të përbashkëta me fakultetet e rajonit;</li> <li>• Mobilitet të stafit dhe studentëve përmes programit Erasmus.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ndryshimet ligjore që kanë të bëjnë me tregun e punës;</li> <li>• Largimi i të rinjve nga vendi, mungesa e perspektivës.</li> <li>• Konkurrenca me universitete të tjera publike dhe private në një hapësirë të ngushtë gjeografike.</li> </ul>

## 11. KONKLUDIM

Lidhur me aktivitetet shkencore dhe arsimore janë marrë hapa të ndryshëm në komunikimin ndërkombëtar dhe kombëtar, të cilat me projektet e realizuara gjatë vitit akademik 2016/17, 2017/18, dhe 2018/19, kanë pasur ndikim konkret në cilësinë e procesit hulumtues shkencor/artistik e arsimor në institucionin përkatës.

Në kontekst të veprimeve të mëtejshme sugjerohet nga ana e stafit akademik që komunikimi ndërkombëtar të vazhdojë edhe më tej me interes më të madh dhe të mundësohet me të njëjtin veprim edhe shkuarja e profesorëve tanë në cilësi të profesorit në fakultete të ndryshme të fushës së artit në universitetet me të cilat kemi marrëveshje bashkëpunimi.

## **Përfundim dhe sugjerime**

Fakulteti i Arteve daton që nga themelimi i Universitetit Shtetëror të Tetovës e deri më sot. Prej themelimit të Universitetit e deri në vitin 2004 Fakulteti i Arteve ka pasur vetëm tre programe studimore; Arti Figurativ, Arti Muzikor dhe Arti Dramatik. Prej vitit 2004 programet studimore; Arti Figurativ, Arti Muzikor kanë vepruar në kuadër të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Arteve. Me akreditimin e programeve të reja studimore Fakultetit të Arteve u themelua si njësi në kuadër të Universitetit të Tetovës (Gazeta Zyrtare e RM-së nr.81 e vitit 2008), me programet studimore, Arti Figurativ, Arti Muzikor dhe Arti Dramatik. Procesi mësimor realizohet me mësim teorik dhe praktik. Për realizimin e pjesës praktike përdoren hapësirat e fakultetit, kurse për pjesën pedagogjike shkollat fillore me të cilat fakulteti ka nënshkruar marrëveshje paraprake bashkëpunimi. Procesi mësimor realizohet nga gjithsej 32 mësimdhënës me marrëdhënie të rregullt pune dhe mbi 30 bashkëpunëtorë (mësimdhënës dhe asistentë) të angazhuar me kontratë pune. Prej numrit të përgjithshëm të stafit akademik (të rregullt dhe të angazhuar me kontratë) mund të shihet se më shumë dominon gjinia mashkullore me 76% dhe 24% gjinia femërore. Në Fakultetin e Arteve në vitet akademike 2016/17, 2017/18 dhe 2018/19 në të gjitha programet studimore, duke përfshirë edhe numrin e studentëve që për herë të dytë e kanë regjistruar vitin, janë regjistruar 414 studentë.

Për më tepër, që të rritet informimi i studentëve për të gjitha çështjet e lartpërmendura si dhe çështje tjera studentore, sugjerohet që:

- Të përpilohet pako informative/broshurë për informim të studentëve të Fakultetit të Arteve;
- Takim i koordinatorit për ECTS dhe shefave të programeve studimore me studentët (çdo fillim të vitit akademik në veçanti me ata të vitit të parë) për të prezantuar rolin dhe funksionin e koordinatorit, sistemin e kredive, bartjen e kredive, lëndët opcionale etj.;
- Të vendoset kuti për sugjerime/kritika të studentëve;
- Të merren parasysh dhe të reflektohet ndaj sugjerimeve, ankesave dhe kritikave të studentëve nga ana e udhëheqësisë së fakultetit.

Komisioni për Evaluim të brendshëm i Fakultetit të Arteve në përbërje:

1. Prof. Inord. Agron Abduli - kryetar

2. Prof. Ord. Senad Abduli - anëtar


3. Prof. Ord. Bashkim Mexhiti - anëtar

4. Prof. Inord. Fatos Lumani - anëtar

5. Doc. Teuta Halimi - anëtar

6. Dardane Xheladini - anëtar-student

7. Remzije Lloga - anëtar-student



Handwritten signatures in blue ink corresponding to the list of committee members. The signatures are written over horizontal lines. The first signature is for Prof. Inord. Agron Abduli, the second for Prof. Ord. Senad Abduli, the third for Prof. Ord. Bashkim Mexhiti, the fourth for Prof. Inord. Fatos Lumani, the fifth for Doc. Teuta Halimi, the sixth for Dardane Xheladini, and the seventh for Remzije Lloga.